



Pozicioni:	Punonjës/e Sociale
Vendndodhja:	Qendra Komunitare Aleanca LGBTIQ+, Tiranë
Kohëzgjatja:	Kontratë 10 mujore me mundësi zgjatjeje deri në dy vjet, bazuar në performancë.
Orari i punës:	Me kohë të plotë (40 orë në javë)
Koha e Fillimit:	Brenda muajit Prill 2025

I. Konteksti

- Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTIQ+ është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që parashikon një shoqëri të lire, të hapur, dhe të barabartë për të gjithë identitetet seksuale e gjinore njerëzore. Aleanca ka për qëllim krijimin dhe fuqizimin e komunitetit shqiptar LGBTIQ+ , mbrojtjen e të drejtave të tij dhe luftën kundër diskriminimit të bazuar tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Aleanca nisi aktivitetet e saj në Mars të vitit 2009, kur një grup vullnetarësh LGBTIQ+ filluan punën mbi hartimin e programeve dhe aktiviteteve për komunitetin, dhe u regjistrua si organizatë jo-fitimprurëse në Nëntor 2009.

Programet dhe aktivitetet e Aleancës LGBTIQ+ përfshijnë:

- Fuqizimi i komunitetit LGBTIQ+ në Shqipëri përmes informimit dhe edukimit pranë qendrës Aleanca LGBTIQ+ si dhe në terren.
- Rritja e aksesit të komunitetit LGBTIQ+ drejt shërbimeve shëndetësore, të punësimit, strehimit, formimit profesional, edukimit në nivel lokal dhe rajonal, përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe menaxhimit të rasteve që frekuentojnë qendren.
- Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të shëndetësisë, mjek të përgjithshëm, infermiere dhe specialist të shëndetit publik për ceshtje që lidhen me të drejtat e komunitetit LGBTIQ+ me qëllim krijimin e shërbimeve miqësore.



- Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të edukimit, mësues të ciklit të ulët dhe të mesëm, pedagogë të Universiteteve publike dhe jopublike për ceshtje që lidhen me të drejtat e komunitetit LGBTI+ me qëllim uljen e stigmës dhe diskriminimit, si dhe trajtimin e rasteve të bullizmit dhe krijimin e shërbimeve miqësore, për komunitetin LGBTI+ .
- Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të shërbimit social në nivel local dhe rajonal, punonjës social të qendrave ditore, njësi administrative të pushtetit local, shërbimit social rajonal, psikologë të shkollave dhe qendrave sociale mjek të përgjithshëm, për ceshtje që lidhen me të drejtat e komunitetit LGBTI+ me qëllim identifikimin, tratimin dhe referimin e rasteve të komunitetit LGBTI+ dhe krijimin e shërbimeve miqësore.
- Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të punonjësve të policisë, për ceshtje që lidhen me të drejtat e komunitetit LGBTI+ , identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve të diskriminimit dhe dhunës që ushtrohet ndaj komunitetit LGBTI+ si dhe krijimin e shërbimeve miqësore.
- Organizim i eventeve sociale të vazhdueshme për komunitetin me synim njohjen mes tyre dhe informimin për çështje LGBTI+ (grupe javore diskutimi, festa javore, shfaqje filmash, pikniqe, skuadër futbollit për vajza etj).
- Ndërlidhje e komunitetit shqiptar LGBTI+ me ato në rajon (informim i vazhdueshëm për zhvillime në rajon).
- Mbështetje për personat LGBTI+ dhe familjarët e tyre që duan të ndajnë problemet me dikë që mund t'i kuptojë dhe ndihmojë.
- Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.
- Ndërgjegjësim dhe edukim publik për të drejtat e komunitetit LGBTI+ në Shqipëri. Diskutim me të rinjtë e shkollave të Shqipërisë në lidhje me çështjet LGBTI+ .
- Fushata publike informimi nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese (fletushka, postera, broshura) në formë elektronike dhe duke ndaluar njerëzit në rrugë (p.sh. Doktorët e Homofobisë).
- Prezantime dhe leksione në universitete mbi historikun e lëvizjeve për të drejtat e njerëzve LGBTI+ , për komunitetin LGBTI+ në Shqipëri etj.
- Pjesëmarrje në emisione televizive dhe radiofonike.



- Botime shkrimesh dhe intervista në median e shkruar
- Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për çështje të të komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.

Aleanca LGBTI+ I kërkon të punësojë një Punonjës/e Social për ofrimin e shërbimeve të fushës sociale dhe realizimin e aktiviteteve fuqizuese me dhe për qytetarët LGBTI+.

II. Përshkrimi i punës:

1. Roli i punonjësit social

Punonjësi social do të angazhohet drejtpërdrejtë me qytetarët LGBTI+ në nevojë, në qendrën ditore, online dhe komunitet, duke kontribuar aktivisht në mirëqenien e përgjithshme të tyre. Punonjësi social do të lehtësojë aksesin në shërbimet thelbësore nëpërmjet fuqizimit individual të qytetarëve LGBTI+, avokimit për raste të veçanta dhe në tërësi për realizimin e të drejtave individuale dhe të përgjithshme, dhe ngritjes së kapaciteteve të shërbim ofruesve.

2. Përgjegjësitë kryesore

Punonjësi Social do të jetë përgjegjës për ofrimin e mbështetjes gjithëpërfshirëse psikosociale,

i. Menaxhimi i rasteve

- Identifikimi i qytetarëve LGBTI+ në nevojë dhe kryerja e vlerësimit të plotë të nevojave, statusit psikosocial dhe aftësive të individëve LGBTI+ që vizitojnë qendrën.
- Zhvillimi dhe zbatimi i planeve mbështetëse të individualizuara në koordinim me psikologun dhe ekipin multidisiplinar të qendrës.



- Të mbikëqyrë dhe ndjekë zbatimin e planeve individuale të mbështetjes dhe të sigurojë që të gjitha ndërhyrjet e nevojshme të zbatohen në mënyrë efektive.
- Të sigurojë mbështetje individuale dhe në grup për personat LGBTI+ që frekuentojnë qendrën, si dhe familjet e tyre dhe rrjetet e ngushta sipas nevojës.
- Të mbajë shënime të sakta dhe konfidenciale të rasteve, duke përditësuar profilet individuale për të siguruar mbështetje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të rasteve.
- Të bashkëpunojë me organizatat dhe institucionet publike për menaxhimin e rasteve, duke siguruar referime të përshtatshme dhe akses në shërbimet sociale dhe ligjore.

ii. Fuqizimi Individual

- Të asistojë individët LGBTI+ në marrjen e mbështetjes administrative si karta identiteti, dokumentacion ligjor dhe ndihmë financiare për shërbimet thelbësore.
- Të mbështesë iniciativat e këshillimit për karrierë, duke ndihmuar individët që frekuentojnë qendrën me shkrimin e CV-së, aplikimet për punë dhe referimet në zyrat e punësimit.
- Të ofrojë këshillim psiko-social online për qytetarët LGBTI+ dhe familjet e tyre sipas nevojës.

iii. Ngritja e kapaciteteve

- Të lehtësojë seminare, aktivitete ndërgjegjësuese dhe sesione trajnimi për profesionistë si punonjësit socialë, oficerët e policisë, punonjësit shëndetësorë dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për individët LGBTI+.
- Të avokojë dhe të llobojë për përmirësimin e aksesit në shërbimet dhe institucionet publike për individët LGBTI+, duke siguruar trajtim dhe mbrojtje të barabartë.
- Të kontribuojë në hartimin dhe zbatimin e materialeve informative, duke përfshirë broshura dhe përmbajtje online, për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat dhe nevojat e komunitetit LGBTI+.
- Të mbështesë në organizimin e aktiviteteve sociale dhe të ndërtimit të komunitetit pranë qendrës Aleanca LGBTI+ për të rritur integrimin dhe fuqizimin e anëtarëve të komunitetit.



iv. Menaxhimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Performancës

- Të punojë në zbatim të kontratës individuale të punësimit përfshirë përshkrimin e punës
- Të zbatojë më përpikmëri standartet e shërbimit, politikat dhe rregulloret e shërbimit dhe organizatës.
- Të marrë pjesë aktive në vlerësimin e performancës individuale (dy herë në vit)
- Të dokumentojë punën, hartojë raporte periodike dhe tematike sipas kërkesave dhe nevojës.
- Të drejtojë takimet për menaxhmin e rasteve.

v. Përgjegjësi dhe kërkesa të përgjithshme

- Të marrë pjesë takimet e skuadrës për menaxhmin, supervizimin dhe vlerësimin.
- Të marrë pjesë në seancat e detyrueshme për njohjen dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes, sigurisë dhe shëndetit.
- Të ruajë konfidencialitetin në lidhje me informacionin e dhënë nga dhe për qytetarët LGBTIQ+.
- Të zbatojë të gjitha kërkesat ligjore dhe të organizatës në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale .
- Të sigurohet që informacioni i shpërndarë të jetë i standardve profesionale duke ju përshtatur karakteristikave individuale të qytetarëve .
- Të kontribuojë aktivisht në organizimin e Tirana PRIDE dhe Javës së Krenarisë
- Të angazhohet në zbatimin dhe promovimin, e vlerave, etikën dhe politikave të Organizatës Aleanca.
- Të angazhohet për të punuar si pjesë e ekipit të Aleancës.
- Të punojë me iniciativën e tij/saj, edhe nën presion, me dhe, ndonjëherë, pa mbikëqyrje.
- Të gjithë personelit mund t'i kërkohet të ndërmarrë detyra dhe përgjegjësi të tjera siç përcaktohet nga ekipi menaxhues, në bazë të rastit dhe apo situatës.



3. Orari dhe Kushtet e Punës

- Punonjësi/ja sociale do të punojë në Qendrën Komunitare Aleanca LGBTI+ nga e Hëna në të Premte, nga ora 10:00 deri në orën 18:00.
- Roli mund të kërkojë punë të herëpashershme jashtë orarit zyrtar të punës dhe disponueshmëri në fundjavë me kompensim shtesë sipas ligjit shqiptar të punës.
- Pozicioni mund të përfshijë shoqërimin e individëve LGBTI+ në institucionet përkatëse për mbështetje ligjore, mjekësore ose administrative.
- Pagesa bruto , duke filluar nga 100.000 Lek,

III. Kriteret e Punësimit

1. Eksperienca

- Minimumi pesë vjet përvojë pune si punonjës social, mundësisht në një qendër ditore ose një mjedis ofrues shërbimi për qytetarët dhe/ose komunitetet vulnerabël.
- Njohuri të avancuara mbi çështjet LGBTI+, kuadrin ligjor, diskriminimin dhe sfidat unike me të cilat përballet komuniteti në Shqipëri.
- Aplikuesit nuk duhet të kenë dënime të mëparshme penale, të konfirmuara përmes një kontrolli zyrtar të historikut ligjor. Dëshmia penalitetit të dërgohet bashkangjitur aplikimit.

2. Edukimi

- Diplomë universitare në Shkenca Sociale (Punë Sociale, Psikologji ose fusha të ngjashme) (kërkohet diplomë Bachelor, e preferuar Master).

3. Aftësitë

- Aftësi të forta komunikimi dhe pune në grup, me një aftësi të demonstruar për të punuar në një mjedis multidisiplinar.
- Aftësi për të punuar nën presion dhe për të trajtuar situatat emergjente me qetësi dhe efikasitet.



- Aftësi të mira të gjuhës angleze dhe aftësi në aplikacionet bazë kompjuterike.
- Aftësia për të inkurajuar, frymëzuar dhe fuqizuar individët në veccanti qytetarët LGBTI+ I.
- Angazhimi i demonstrueshëm për të luftuar të gjitha format e diskriminimit.
- Aftësi për të punuar në një mjedis që merret me çështje sfiduese dhe të ndjeshme.
- Aftësi për të dhënë përparësi dhe menaxhuar ngarkesën e punës.
- Aftësi për të komunikuar, zhvilluar raporte dhe për të ndërtuar marrëdhënie mbështetëse me njerëzit.
- Aftësi për të mbledhur të dhënat e monitorimit dhe për të shkruar raporte të progresi/ndikimit.

IV. Procedura e Aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin:

1. Një CV të detajuar.
2. Një letër motivimi që përshkruan përvojën e tyre përkatëse dhe motivimin për të aplikuar.
3. Kopje të certifikatave dhe referencave përkatëse arsimore.
4. Kontaktet e tre punëdhënësve të fundit si referencë.

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën e emailit livia.zotrija@gmail.com me Subjektin “Aplikim në pozicionin e Punonjësit Social” deri në datën 11 Prill 2025. Aplikimet e dërguara pas datës 11 Prill nuk do të merren parasysh. Aleanca LGBTI+ inkurajon aplikime nga individë me prejardhje dhe identitete të ndryshme.

Ky pozicion ofron një mundësi për të bërë një ndikim domethënës në jetën e individëve LGBTI+ I+ në Shqipëri, duke kontribuar në aksesin e tyre në shërbime, sigurinë dhe mirëqenien përmes mbështetjes dhe advokimit të përkushtuar profesional.